

NJOFTIM PËR VENDE TË LIRA PUNE

Në zbatim të Ligjit Nr. 10164 datë 15/10/2009, "Për Autoritetin Rrugor Shqiptar", Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.757, datë 13/12/2024" Për disa ndryshime në Vendimin Nr.276, datë 16/05/2018, të Këshillit të Ministrave 'Për miratimin e mënyrës së organizimit, të strukturës, organikës dhe statutit të Autoritetit Rrugor Shqiptar", të ndryshuar dhe Rregullores së Brendshme Nr.7493/2, datë 04/09/2018, miratuar me Vendim Bordi Nr.10, datë 04/09/2018, të ndryshuar, konkretisht neni 16 "Kërkesa të përgjithshme për të qenë punonjës i ARRSH" dhe neni 17 "Kërkesa specifike dhe procedura e pranimit në punë si punonjës i Autoritetit":

A: Numri i vendeve vakante në pozicionet:

| | |
|--|----------------------------|
| Drejtore QKMT | 1(një) vend |
| Përgjegjës Sektori QKMT | 1(një) vend |
| Inspektor (Monitorimi) | 5(pesë) vende |
| Specialist (Përpunues Informacioni Supervizor) | 5(pesë) vende |
| Specialist (Operator Salle) | 8(tetë) vende |
| Specialist (Dispecer) | 5(pesë) vende |
| Specialist (Operator i Thirrjeve) | 4(katër) vende |
| Përgjegjës Sektori për Operimin në terren | 1(një) vend |
| Specialist (Operator terreni) | 16(gjashtëmbëdhjetë) vende |

B: Kërkesat e përgjithshme,

Që duhet të plotësojnë kandidatët për punësim si personel administrativ në Autoritetin Rrugor Shqiptar janë:

- Të kenë shtetësinë shqiptare.
- Të gjëzojnë zotesi të plotë për të vepruar.
- Të përbushë kërkesat për llojin dhe nivelin arsimor, si dhe të zotërojë aftësitë profesionale të domosdoshme, për vendin përkatës të punës sipas kriterieve të miratuara.
- Tëjenë të aftë për punë.
- Të mos jenë të dënuar me një vendim gjykate të formës së prerë.
- Të mos jenë ortakë apo aksionare të subjekteve të cilat kanë kontrata të lidhura me ARRSH-në.
- Të mos jenë punonjës me kohë të pjesshme apo të plotë në subjektet me aktivitet privat në fushën e ndërtimit të cilat kanë kontrata të lidhura me ARRSH-në.



8. Të gëzojnë integritet moral dhe profesional dhe për të cilët të mos jetë marrë masa disiplinore për cenim te rregullave te etikes.
9. Të mos kenë lidhje familjare me anëtaret e Bordit apo me punonjës të tjerë të administratës, me të cilët kanë lidhje hierarkie.
10. Personat që kandidojnë për pozicionin përgjegjes sektori, duhet të kenë edhe të paktën 2 -vite eksperiencë pune.
11. Personat që kandidojnë për pozicionin Drejtor Drejtorie duhet të kenë edhe të paktën 5- vite eksperiencë pune.

C:Kërkesa specifike /kriteret sipas pozicionit

Drejtoria e Qendrës Kombëtare të Monitorimit të Trafikut (QKMT) do të operojë levizjen e trafikut në rrugët kombëtare, imazhet në kohë reale të kushteve të trafikut, duke kordinuar në të njëjtën kohë veprimet me policinë dhe ekipet e tjera të zbatimit të ligjit dhe reagimin emergjent ndaj incidenteve/aksidenteve rrugore.

- QKMT do të funksionojë 24/7.
- Programi ditor zgjat tetë (8) orë me përjashtim të gjysmë ore për dorëzim.
- Do të ketë turne tre ditore me staf të plotë: 6:00 – 14:00, 14:00 – 22:00, 22:00 – 6:00.
- Do të ketë një turn (1) natë me staf të reduktuar: 22:00 – 06:00.
- Në turnin e natës, është e pranueshme që një Operator Trafiku të mbulojë më shumë se një rajon.

Drejtor i QKMT

Përgjegjësitë:

- Administrimi i QKMT
- Monitorimi i situatës së përgjithshme të personelit, kërkesave dhe nevojave për optimizimin e performancës së QKMT
- Marrja e vendimit për zgjerimin e sistemeve të ITS (Sistemet e Transportit Inteligjent).
- Marrja e vendimit për të përmirësuar sistemet e ITS.
- Kontrolli i funksionimit të ITS.

Aftësitë e kërkua:

- Diplomë universitare Master në Inxhinieri ose ekuivalente.
- Njohja e mirë e gjuhës angleze, të folurit e gjuhës shqipe.
- Të ketë përvojë në planifikim, menaxhim dhe organizim të punës dhe burimeve.
- Njohuri bazë në menaxhimin e trafikut.
- Njohuri të sistemit operativ Windows.
- Njohuri të mjeteve të Office dhe shfletuesve të internetit.



Përgjegjës sektori QKMT

Përgjegjësitë:

- Monitorimi i situatës së përgjithshme të trafikut dhe kërkesave dhe nevojave në rrugë (rikonstruksioni i kryqëzimeve, shtimi i vendeve të parkimit, etj.).
- Marrja e vendimit për zgjerimin e sistemeve të ITS (Sistemet e Transportit Inteligjent).
- Marrja e vendimit për të përmirësuar sistemet e ITS.
- Kontrolli i funksionimit të ITS.

Aftësitë e kërkua:

- Diplomë universitare Master në IT, Transport, Elektronikë, Elektrike ose ekivalente.
- Njohja e mirë e gjuhës angleze, të folurit e gjuhës shqipe.
- Të ketë përvojë në planifikim, menaxhim dhe organizim të punës dhe burimeve.
- Njohuri në menaxhimin e trafikut.
- Njohuri të sistemit operativ Windows.
- Njohuri të mjeteve të Office dhe shfletuesve të internetit

Inspektor (Monitorimi)

Menaxherët e turneve do të janë përgjegjës për operacionet e përgjithshme, efektivitetin dhe efikasitetin e ndërrimit të caktuar.

Mbikëqyrësi i Operatorit do të monitoroje dhe mbikëqyrë të gjitha aktivitetet e përditshme në qendrën e kontrollit.

Përgjegjësitë:

- Monitorimi i situatës së përgjithshme të trafikut dhe kërkesave dhe nevojave në rrugë. (Rikonstruktion planimetrie dhe levizje, shtim linjave lëvizjes për të shmangur bllokimet etj...).
- Koordinon aktivitetet ditore të QKMT-së për të siguruar funksionalitetet e platformës RRMS (Projekti i bazuar në mirëmbajtjen dhe sigurinë e Rrugëve).
- Marrja e vendimeve në vend për të ruajtur fluksin e trafikut.
- Operacionet e kontrollit të qendrës.

Aftësitë e kërkua:

- Diplomë universitare Master në fushën teknike si IT, Transport, Elektronikë, Elektrike etj. ose ekivalente.
- Njohja e mirë e gjuhës angleze, të folurit e gjuhës shqipe.



- Të ketë përvojë në planifikim, menaxhim dhe organizim të punës dhe burimeve
- Njohuri në menaxhimin e trafikut
- Njohuri të sistemit operativ Windows
- Njohuri të mjeteve të Office dhe shfletuesve të internetit
- Aftësia për të kryer trajnime.

Specialist (Perpunues informacioni Supervizor)

Mbikëqyrësi i Operatorit do të planifikojë, monitorojë dhe mbikëqyrë të gjitha aktivitetet operative të përditshme në QKMT.

Mbikëqyrësi i Operatorit do të jetë përgjegjës për menaxhimin e sigurisë së përdoruesit të QKMT dhe caktimin e aktiviteteve ditore të operatorit. Mbikëqyrësi i Operatorit gjithashtu do të gjenerojë të gjitha statistikat dhe raportet e trafikut.

Përgjegjësitë:

- Organizon aktivitetet ditore të operatorëve.
- Menaxhon dhe monitoroni operacionet e plota dhe operatorët QKMT në baza ditore.
- Monitoron statusin funksional të të gjitha sistemeve.
- Përgjigjet ndaj një statusi funksional të paqëndrueshëm duke e sqaruar atë me operatorët dhe duke iu drejtar personelit të mirëmbajtjes.
- Përgatit katedrën e ngjarjeve kritike të planifikuara.
- Siguron statistika dhe raportime për të gjitha nënsistemet në baza ditore/javore.
- Përgjegjës për vendimet e marra të kontrollit të trafikut.

Aftësitë e kërkua:

- Diplomë universitare Master në Transport, IT, Elektronikë, Elektrike ose ekivalente.
- Njohja e mirë e gjuhës angleze, të folurit e gjuhës shqipe.
- Të ketë përvojë në planifikim, menaxhim dhe organizim të punës dhe burimeve.
- Njohuri të sistemit operativ Windows.
- Njohuri të mjeteve të Office dhe shfletuesve të internetit.
- Me përvojë në përgatitjen e planeve dhe procedurave për funksionimin e sistemeve të menaxhimit të trafikut.
- Aftësia për të kryer trajnime.



Specialist (Operator Salle)

Operatori duhet të monitorojë funksionet e caktuara të ITS, të përgatisë ngjarje të planifikuara me ndikim në trafik dhe t'u përgjigjet incidenteve të trafikut.

Përgjegjësitë:

- Monitorimi i nënsistemeve të ITS.
- Monitorimi i trafikut nëpërmjet funksionit të caktuar të ITS.
- Monitorimi dhe menaxhimi i alarmeve të sistemit në funksionin e caktuar të ITS (manual dhe i automatizuar).
- Konfirmon / refuzon alarmet e nënsistemit duke përdorur listën e alarmeve QKMT.
- Verifikon dhe trajton incidentet/ngjarjet.
- Siguron statistika dhe raportime për nënsistemet e tij të caktuara të ITS.
- Aftësia për të marrë / mos marrë masa të kontrollit të trafikut në rast incidentesh / ngjarjesh.

Aftësitë e kërkuara:

- Diplomë universitare Bachelor në Transport, IT, Elektronikë, Elektrike ose ekivalente
- Preferohet njohja e gjuhës angleze.
- Njohuri të sistemit operativ Windows.
- Njohuri të mjeteve të Office dhe shfletuesve të internetit.
- Aftësia për të kryer trajnime.

Specialist (Dispeçer)

Dispeçeri do të menaxhojë veprimet e caktuara të ITS, do të përgatisë ngjarje të planifikuara me ndikim në trafik dhe do t'i përgjigjet incidenteve të trafikut.

Përgjegjësitë:

- Dokumentimi i procesit të veprimtarisë së nënsistemeve të IST-it në situata emergjente.
- Koordinimi i trafikut nëpërmjet funksioneve dhe bashkëpunëtorëve të caktuar të ITS.
- Dokumentimi dhe mbyllni të gjithë alarmet e caktuar nga mbikëqyrësit e ITS (manual dhe i automatizuar).
- Konfirmon / refuzon alarmet e nënsistemit duke përdorur listën e alarmeve QKMT.
- Verifikim, trajtim dhe dokumentim i incidenteve/ngjarjeve.
- Siguron statistika dhe raportime për operacionet e tij të caktuara të ITS.



- Aftësia për të marrë / mos marrë masa të kontrollit të trafikut në rast incidentesh / ngjarjesh.

Aftësitë e kërkuar:

- Diplomë universitare Bachelor në Transport, IT, Elektronikë, Elektrike ose ekivalente në fushën e Akademisë së Rendit (kandidatë të preferuar nga Forca e Policisë).
- Preferohet njohja e gjuhës angleze.
- Njohuri të sistemit operativ Windows.
- Njohuri të mjeteve të Office dhe shfletuesve të internetit.
- Aftësia për të kryer trajnime.

Specialist (Operator i thirjeve)

Qendra Thirrjeve (Call Centre) do të menaxhojë veprimet e caktuara në thirjet e marra dhe do të ekzekutojë skriptet dhe urdhrat e përgatitur nga QKMT.

Përgjegjësitë:

- Dokumentimi i procesit të aktivitetit në call center.
- Koordinimi i rrjedhës së thirrjeve sipas funksioneve dhe bashkëpunëtorëve të caktuar.
- Dokumentimi dhe mbyllja e të gjithë alarmeve të caktuar nga sistemi (manual dhe i automatizuar).
- Verifikimi i incidenteve me dispeçerët dhe operatorët e ITS.
- Siguron statistika dhe raportime në baza ndërrime.

Aftësitë e kërkuar:

- Diplomë universitare Bachelor ose ekivalente.
- Preferohet të njohë gjuhën angleze dhe shqipe.
- Njohuri të sistemit operativ Windows.
- Njohuri të mjeteve të Office dhe shfletuesve të internetit.
- Aftësia për të marrë pjesë në trajnime.

Përgjegjës Sektori për Operimin në Teren

Përgjegjësitë:

- Monitorimi i situatës së përgjithshme të trafikut dhe kërkesave dhe nevojave në rrugë (rikonstruksioni i kryqëzimeve, shtimi i vendeve të parkimit, etj.).
- Marrja e vendimit për zgjerimin e sistemeve të ITS (Sistemet e Transportit Inteligjent).



- Marrja e vendimit për të përmirësuar sistemet e ITS.
- Kontrolli i funksionimit të ITS.

Aftësitë e kërkuaara:

- Diplomë universitare Master në IT, Transport, Elektronikë, Elektrike ose ekivalente.
- Njohja e mirë e gjuhës angleze, të folurit e gjuhës shqipe.
- Të ketë përvojë në planifikim, menaxhim dhe organizim të punës dhe burimeve.
- Njohuri në menaxhimin e trafikut.
- Njohuri të sistemit operativ Windows.
- Njohuri të mjeteve të Office dhe shfletuesve të internetit

Specialist (Operator Tereni)

Teknikët e terrenit do të monitorojnë, riparojnë dhe zëvendësojnë të gjitha pajisjet e kërkuaara harduerike në vendet në terren të Platformës QKMT. Teknikët do të kryejnë mirëmbajtjen parashikuese, parandaluese dhe korriguese të të gjitha pajisjeve të nënsistemit të Platformës QKMT të instaluara në kantiere.

Përgjegjësitë:

- Monitorimi i funksionalitetit të të gjitha nënsistemeve.
- Zgjidhja e problemeve në pajisje në QKMT dhe në site.
- Monitorimi dhe menaxhimi i alarmeve të sistemit.
- Programimi i kontrollorëve të trafikut.
- Ngarkimi i softuerit të integruar në kontrollorët e sinjaleve të trafikut dhe vendosja e konfigurimeve.
- Siguron riparimin dhe zëvendësimin e kontrollorëve, sinjaleve, instalimeve elektrike, detektorëve dhe pajisjeve të tjera.
- Sigurimi dhe ekzekutimi i procedurave të programimit dhe mirëmbajtjes me pajisje.

Aftësitë e kërkuaara:

- Diplomë universitare Bachelor në Transport, IT, Elektronikë, Elektrike ose ekivalente (Njohuria e aftësive teknike është e domosdoshme)
- Njohuri të mira të gjuhës angleze dhe shqipe.
- Njohuri të sistemit operativ Windows.
- Njohuri të mjeteve të Office dhe shfletuesve të internetit.
- Njohuri të programimit të kontrollorëve, kamerave, detektorëve dhe pajisjeve të tjera në QKMT dhe në site.



D: Dokumentat për dorëzim

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë Drejtorisë së Shërbime të Brendshme të Autoritetit Rrugor Shqiptar Tiranë këto dokumente:

1. Curriculum Vitae (në formatin Europass)
2. Diplomë universitare dhe/ose masteri e noterizuar
3. Listë notash e noterizuar
4. Librezën e punës (nëse ka)
5. Librezën e sigurimit shoqëror e shëndetësor (nëse ka)
6. Vërtetim shëndetësor nga Komisioni Mjeko-Ligjor
7. Fotokopje ID
8. Adresën e vendbanimit ose ndonjë dokument tjetër të nevojshëm sipas specifikës së vendit të punës.
9. Dëshmi penaliteti
10. Dëshmi të ndryshme kualifikimi.

*Mungesa e një prej dokumentacioneve të kërkua më sipër, sjell s'kualifikim të kandidatit.

Dokumentacioni i dorëzuar nuk do të kthehet mbrapsht, pasi bëhet pjesë e arkivës së Institucionit.

Kandidatët e interesuar, duhet të dorëzojnë dokumentacionin e kërkuar në Sektorin e Arkivë-Protokollit, në Autoritetin Rrugor Shqiptar (Adresa: Rruga e Sami Frashëri, Nr.33 Tiranë)

Afati i dorëzimit të dokumentacionit: **20/12/2024 – 30/12/2024 (10 ditë).**

Përzgjedhja e kandidatit fitues do të bëhet nëpërmjet konkurrimit me dosje dhe me intervista të drejtpërdrejta. Për çdo paqartësi mund të dërgohet email në adresën info@arrsh.gov.al

E: Mënyra e vlerësimit:

Në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën.

Në lidhje me intervistën e punës kandidatët do të vlerësohen për njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës; Eksperiencën e tyre të mëparshme; motivimin, aspiratat dhe pritshmërinë e tyre për karrierën.

